



## NJOFTIM

U themelua më 16 dhjetor 2022, në Milano, Shkolla Ballkanike e Energjisë (BES) me seli në ambientet e Rregullatorit Italian. BES do të promovojë harmonizimin e kornizave rregullatore në nivel rajonal, me synim mbështetjen e zhvillimit të Tregut të Energjisë në Ballkan dhe integrimin të këtij të fundit në atë Evropian. Pas iniciativës së ndërmarrë nga ARERA, autoritetet rregullatore të Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut janë anëtarë themelues. Autoritete të tjera rregullatore do të mund ti bashkëngjiten në muajt në vazhdim. BES erdhi si vazhdimësi e eksperiencës së suksesshme të projektit KEP (Know How Exchange Programme), i cili u promovua dhe koordinua nga ARERA gjatë 4 viteve të fundit, si pjesë e strukturës së programit të financimit të Iniciativës së Evropës Qëndrore (CEI). Aktivitetet e BES do të jenë kryesisht të fokusuar në zhvillimin e rrjeteve të energjisë dhe gazit, integrimin të RES, bashkimit të tregut, dhe aktiviteteve të tjera

relevante, nën kujdesin e tranzicionit të energjisë dhe aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe shkëmbimit të njohurive midis Rregullatorëve. Anëtarët

themelues të shoqatës emëruan Z. Stefano Saglia, anëtar i Bordit të ARERA, si Kryetar për periudhën 2023-24, i cili konfirmoi angazhimin e ARERA për shtrirjen e tregut



Evropian të energjisë në rajonin e Ballkanit, veçanërisht në këtë moment të rëndësishëm duke marrë parasysh rritjen e shpejtë të numrit të investimeve në infrastrukturë.